



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNA E MITROVICËS SË VERIUT PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komuna e Mitrovicës së Veriut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komuna e Mitrovicës së Veriut (Mitrovica e Veriut), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komuna e Mitrovicës së Veriut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Mitrovica e Veriut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komuna e Mitrovicës së Veriut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komuna e Mitrovicës së Veriut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komuna e Mitrovicës së Veriut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komuna e Mitrovicës së Veriut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komuna e Mitrovicës së Veriut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat në të cilat janë vërejtur mangësi sa i përket raportimit financiar kishin të bënin me, mos regjistrimi i pasurive jo kapitale në kuadër të sistemit e-pasuria, mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive, mos planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë, mos zbatim i tarifave përkatëse për leje të ndërtimit si dhe mos themelimi i njësisë së auditimit të brendshëm (NJAB).

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja dy (2) pjesërisht të përsërita dhe dy (2) të përsëritura.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2025, ishin 106,157€, përderisa ishin realizuar 202,047€, pra komuna ka tejkalluar planin e të hyrave rreth 90%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat jo tatimore respektivisht nga taksat administrative për shërbimet e ofruara komunale ndaj qytetarëve. Po ashtu, komuna për vitin 2025, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku në vlerë totale prej 3,970€.

Çështja A1 - Mos zbatim i tarifave përkatëse për leje të ndërtimit

Gjetja Rregullorja Komunale Nr. 06/2025 për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, neni 19 në kuadër të tabelës 17.11 taksa administrative për leje ndërtimore për kategorinë e parë është caktuar çmimi 1.66€/m², ndërsa në pikën 17.12 taksa administrative për leje ndërtimore për kategorinë e dytë është caktuar tarifa prej 3.07€ për m².

Më datën 03.10.2025 është dhënë leje ndërtimit për kategorinë e dytë për ndërtimin e një objekti banimi kolektiv të kategorisë së dytë në sipërfaqe 12,580m². Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit kemi identifikuar se tarifa e paguar nuk është në përputhje me tarifat e përcaktuara me rregulloren e brendshme.

Sipas kësaj përlllogaritje nga drejtoria për urbanizëm për këtë leje ndërtimi komuna ka inkasuar shumën prej 20,883€ e cila në fakt vlera e saktë sipas tarifës përkatëse do duhej të ishte 38,621€. Nga përlllogaritja e gabuar e tarifës për leje ndërtimit ka rrjedhur një gabim financiar në shumë prej 17,738€.

Mos llogaritja e duhur e tarifës për leje ndërtimi ka ndodhur nga neglizhenca apo pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës, si dhe mungesës së mekanizmave të kontrollit të brendshëm, të cilët nuk kanë siguruar verifikimin me kohë të tarifave për kategorinë e dytë sipas çmimit përkatës.

Ndikimi Moszbatimi i tarifës së saktë për kategorinë e dytë të lejes së ndërtimit ka ndikuar që shuma e paguar nga investitori të jetë më e vogël se sa vlera reale.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se me rastin e shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimit nga drejtoria për urbanizëm të kërkojë dhe të shtojë kontrole që gjatë përcaktimit të shumës për pagesë të bëjnë përlllogaritjen e duhur në mënyrë që leja e ndërtimit të jetë në harmoni me tarifat ashtu siç janë prezantuar në rregulloren përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mungesa e lejes mjedisore për llogaritjen e taksës**Gjetja**

Rregullorja komunale Nr. 06/2025 për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, neni 20 parasheh: Taksën për Leje Mjedisore Komunale (LMK) duke u bazuar në Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr.01/2017 për dhenien e lejes mjedisore komunale parasheh: neni 9 projektet që i nënshtrohen LMK dhe neni 15 paragrafi 1.2 për vlerën investive të projektit mbi 25,000€ paguhet taksa prej 0.2% e vlerës investive të projektit.

Më datë 02.09.2025, në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, është paraqitur një kërkesë për pajisje me leje ndërtimi për një objekt banimi kolektiv me sipërfaqe prej 12,580 m². Gjatë rishikimit të dokumentacionit përkatës, është konstatuar se Drejtoria nuk ka kërkuar lejen mjedisore dhe me këtë rast nuk është bërë përcaktimi i taksës për leje mjedisore komunale mbi të cilën do të llogaritej tarifa në lartësi prej 0.2% të vlerës së investimit. Vlera e investimit të projektit ishte 3,774,180€ dhe si rezultat i kësaj, komuna nuk ka kryer faturimin dhe inkasimin e shumës prej 7,548€.

Deri të mos caktimi i taksës për leje mjedisore ka ardhur si rezultat i mos kërkesës së lejes mjedisore nga komuna për shkak të mos zbatimit të procedurave administrative ligjore.

Ndikimi

Mos përfshirja e aktiviteteve të cilat kërkojnë leje mjedisore dhe moszbatimi i procedurave për leje mjedisore ashtu siç kërkohen me rregullat ligjore mund të ndikojë në mos plotësimin e kushteve të cilat lidhen me natyrën e ndërtimit siç janë mbrojtja e mjedisit, menaxhimit të mbetjeve të ndërtimit, si dhe ndikon në mos inkasimin e të hyrave të cilat rrjedhin taksa për leje mjedisore komunale.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të siguroj se në rastet e tilla të kërkojë lejen mjedisore komunale nga drejtoria përgjegjëse dhe që tarifat të llogariten, dhe të inkasohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C1 - Mos planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë si dhe mungesa e një data bazë për numrin e pronave të komunës****Gjetja**

Ligji Nr.06/L-005 për tatim në pronën e paluajtshme: sipas nenit 12 paragrafi 1. çdo komunë është përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës. Paragrafi 2. Komuna ka përgjegjësitë si në vijim: 2.1. regjistron dhe menaxhon të dhënat e tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë, ashtu siç përcaktohet në aktin nën-ligjor që nxjerr Ministria e Financave në pajtim me paragrafin 5. të nenit 14 të këtij Ligji.

Komuna në buxhetin për vitin 2025 nuk kishte planifikuar të hyra nga tatimi në pronë, por ka arritur të inkasoj të hyra në shumë prej 8,337€ për 627 objekte të regjistruara. Gjatë vitit 2025 komuna po ashtu ka arritur përmes angazhimit të zyrtarëve komunal të identifikoj dhe ti regjistroj edhe 4,217 parcela. Si rezultat i kësaj mund të konsiderohet se komuna në vitin 2025 ka arritur një progres lidhur me identifikimin dhe regjistrimin e pronave si dhe faturimin e tyre.

Deri të mos planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë ka ndodhur si rezultat

i mos identifikimit të plotë të të gjitha pronave si dhe nga mungesa e stafit të mjaftueshme në kuadër të komunës.

Ndikimi

Mos identifikimi dhe regjistrimit jo i plotë i të gjitha pronave dhe mungesa e një analizë për të hyrat e inkasuara nga viti i kaluar ka ndikuar që komuna mos bëjë planifikimin e të hyrave nga tatimi në pronë për vitin 2025.

Rekomandimi C1

kryetari duhet të sigurojë që planifikimi i të hyrave të bëhet në baza reale dhe të mbështetet në analiza të mirëfillta të realizimit paraprak, të shtojë kapaciteteve teknike të stafit për identifikimin dhe regjistrimin e plotë të tatimit në pronë e cila do të mundësoj në arritjen e objektivave komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 15,123,167€, pasurive jokapitale nuk ishin prezantuar, si dhe e stoqeve 1,077€, ku kemi hasur si në vijim:

Çështja C2 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se: “Çdo fundvit bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Po ashtu neni 21 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare”.

Komuna ka themeluar një komision cili ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare vetëm për administratën komunale, por nuk kishte kryer inventarizimin për drejtorinë e shëndetësisë dhe drejtorinë e arsimit, më tutje nuk kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e pasurive me regjistrat kontabël për drejtorin e shëndetësisë dhe drejtorin e arsimit, dhe si pasojë e mos evidencave kontabël, rrjedhimisht nuk dihet diferencat në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare ku do të përgatitej një raport nga komisioni përkatës.

Kjo gjendje ishte për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme lidhur me zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzueseve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

Ndikimi Mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë se komisioni për inventarizimin e pasurive do të përfundojë punën e tyre duke përfshirë të gjitha njësitë komunale si dhe duhet të themelojë komisionin për vlerësimin e pasurive me qëllim të prezantimit dhe raportimit të drejtë dhe të saktë të të gjitha pasurive jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mos regjistrimi i pasurive jo financiare në regjistrin e pasurive si dhe mos mbyllja e investimeve në vijim

Gjetja Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 6, paragrafi 3 përcakton që; “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e pasurisë.” Më tutje neni 11 specifikon se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim, po ashtu neni 11.3 përcakton se: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimin të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi”.

Kemi vërejtur se blerjet e pasurive nën 1,000€ nuk janë regjistruar në e-pasuri si dhe nuk janë prezantuar në kuadër të shënimeve të PFV-ve. Shuma e pa regjistruar për vitin 2025 ishte në vlerë 68,288€ e cila paraqet nën vlerësim të pasurive jo kapitale.

Sipas analizave të pasurive kapitale me vlerë mbi 1,000€ kemi vërejtur se komuna nga viti 2021 deri në fund të vitit 2024 ka regjistruar si në kodin ekonomik investime në vijim në vlerë prej 1,764,555€ për të cilat projekte mund të jenë në përdorim.

Mos regjistrimi i pasurive jo kapitale nën 1,000€ në sistemin e-pasuria dhe mos mbyllja e investimeve në vijim për projektet të cilat mund të jenë në përdorim ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Mos regjistrimi i plotë i pasurive jo kapitale ndikon në nënvlerësim të pasurive dhe rezulton në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyrat financiare vjetore. Po ashtu mos mbyllja e investimeve në vijim për pasuritë kapitale të cilat mund të jenë të finalizuara krijon pasaktësi në PFV pasi ato pasuri nuk amortizohen dhe si të tilla vlerësohen gabimisht.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se zyrtari përgjegjës i pasurive do të regjistrojë të gjitha blerjet e pasurive nën 1,000€ në sistemin e-pasuri dhe të sigurojë se projektet të cilat janë finalizuar por ende janë si investime në vijim të kryhet procesi i mbylljes së tyre me qëllim të raportimit sa më të saktë të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna në vitin 2025 nuk ka themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm (NJAB) dhe nuk ka vepruar konform Rregullores QRK Nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik.

Çështja B2 - Mos themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

- Gjetja** Rregullorja QRK - Nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 paragrafi 1.2 përcakton: "Subjekti i sektorit publik me buxhet prej 3 milion Euro deri në 7 milion Euro të ketë së paku dy (2) auditorë të brendshëm".
- Komuna e Mitrovicës së Veriut nuk ka themeluar NJAB, ndonëse në vitin 2025 kishte shpallur konkurs për rekrutimin e një auditori të brendshëm. Duke marrë parasysh se për këtë pozitë ka pasur mungesë të interesimit të kandidatëve për auditor të brendshëm, rrjedhimisht komuna nuk ka mundur të themeloj Njësine e Auditimit të Brendshëm as në këtë vit.
- Mungesa e kandidatëve të kualifikuar për këtë pozitë ishte shkak i mosplotësimit të kësaj njësie shumë të rëndësishme për komunën.
- Ndikimi** Mos themelimi i NJAB-së, ndikon në pamundësimin e marrjes së veprimeve nga menaxhmenti për të adresuar dobësitë dhe rreziqet e evidentuara në kontrollin e brendshëm.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se do të vazhdoj me veprime për themelimin e NJAB me qëllim të forcimit të qeverisjes së mirë, menaxhimit e rrezikut dhe përmirësimin e kontrolleve financiare, po ashtu duhet të kërkoj që shërbimet e NJAB të kryhen nga Njësia Qëndrore Harmonizuese në kuadër të MFPT.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	6,512,368	6,151,761	3,290,371	2,440,606	1,288,570
Grante Qeveritare - Buxheti	6,406,211	6,026,992	3,169,072	2,344,806	1,139,670
Të bartura nga viti i kaluar	0	12,514	9,922	6,300	117,100
Të hyrat vetanake	106,157	106,157	106,050	89,500	31,800
Donacionet vendore	0	5,881	5,327	0	0
Donacionet e jashtme	0	217	0	0	0

Buxheti final ishte më i ulët se buxheti fillestar për 360,607€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i shkurtimeve buxhetore nga grandit qeveritar në shumën prej 379,219€ dhe rritje për të hyrat e bartura në shumën 12,514€, si dhe donacioneve në shumë prej 6,098€.

Në vitin 2025 komuna kishte shpenzuar 3,290,371€ apo 53% të buxhetit përfundimtar. Ky realizim i buxhetit në nivel kaq të ulët ishte si rezultat i ngecjeve të realizimit të tij kryesisht në kategorinë e pagave dhe mëditje dhe investimeve kapitale.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	6,512,368	6,151,761	3,290,371	2,440,606	1,288,570
Pagat dhe mëditjet	3,270,740	2,891,670	1,356,472	843,382	828,053
Mallrat dhe shërbimet	600,000	600,050	399,429	313,122	116,197
Komunalitë	130,000	130,000	39,100	21,269	3,439
Subvencionet dhe transferet	200,000	200,000	199,393	205,500	241,300
Investimet Kapitale	2,311,628	2,330,040	1,295,978	1,057,333	99,580

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për Paga dhe Mëditje ishte zvogëluar për 379,070€ përkundër kësaj realizimi i buxhetit ishte në shumën 1,356,472€ apo rreth 47% të buxhetit final. Kjo ka ndodhur për shkak të mos plotësimit të pozitave të buxhetuara;
- Buxheti final për Mallra dhe Shërbime ishte realizuar në shumën 399,429€ apo rreth 67%;
- Buxheti final për Shpenzime Komunale ishte realizuar në shumën 39,100€ apo rreth 30%;
- Buxheti final për Subvencione dhe Transfere ishte realizuar në shumën 199,393€; dhe
- Buxheti final për Investime Kapitale ishte realizuar në shumën 1,295,978€ apo rreth 56%, kjo ishte si rezultat i mosrealizimit (kontraktimeve) të projekteve kapitale bazuar në planifikimin e tyre.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2025, ishin 106,157€, përderisa ishin realizuar 202,047€, pra komuna ka tejkaluar planin e të hyrave për 95,890€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat jo tatimore respektivisht nga taksat administrative për shërbimet e ofruara komunale ndaj qytetarëve. Po ashtu, komuna për vitin 2025, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku në vlerë totale prej 3,970€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	106,157	106,157	202,047	99,536	35,427
Të hyrat tatimore	0	0	8,337		
Të hyrat jo tatimore	106,157	106,157	193,711	99,536	35,427

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2024 për Komunën e Mitrovicës së Veriut ka rezultuar me pesë (5) rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2024 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në Kuvendin Komunal të Mitrovicës së Veriut.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, vetëm një (1) rekomandim është zbatuar dy (2) ishin zbatuar pjesërisht, ndërsa dy (2) rekomandime nuk kanë filluar të zbatohen ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj që komisioni për inventarizim të pasurisë të hartojë raportin për inventarizimin e pasurive para datës së përgatitjes së PFV-ve.	Komuna ka themeluar komisionin për inventarizimin e pasurive jo financiare për vitin 2025, por ky komision nuk kishte arritur të përfundojë inventarizimin e plote të njësive të komunës.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se PFV për vitin 2025 janë të plota dhe të sakta, si dhe janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme për përgatitjen e tyre.	Kjo çështje nuk është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të shtoj përpjekjet që të identifikohen dhe regjistrohen në data bazën e tatimit në pronë të gjithë tatim paguesit e komunës, në mënyrë që të hyrat komunale të rriten dhe qytetarët të kuptojnë rëndësinë e tatimit në pronë dhe përfitimet që kanë prej tij duke iu kthyer atij komuniteti në investime.	Komuna ka filluar të ndërmarr veprime për identifikimin dhe regjistrimin e tatimpaguesve, por edhe më tutje duhet të përmbyllet i tërë procesi i regjistrimit të të gjithë tatimpaguesve në sistemin e protaxit.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar, vlerësuar dhe regjistruar në regjistrat përkatës, për siguruar që prezantimi i informatave për pasuritë në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të marr veprime për themelimin dhe plotësimin e NJAB-së me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohësisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Hysen Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit




Florim Maliqi, Anëtar i ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Mitrovicës veriore, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Data: 09 Qershorë 2025, Mitrovicës Veriore,

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.